



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE  
DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN  
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

Tiranë, më 9.11.2024

Lënda: Kthim përgjigje

**Andi Malasi**

**Kryeredaktor, Inside Story**

Adresa elektronike: [andi.malasi9@top-chanel.tv](mailto:andi.malasi9@top-chanel.tv)

Nr. Cel: 069 39 39 353

Përsëndetje!

Në lidhje me kërkesën tuaj për informacion, adresuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore në datën 05.11.2024, nëpërmjet adresës zyrtare elektronike: [kontakt@issh.gov.al](mailto:kontakt@issh.gov.al), me anë të së cilës parashtrohet pyetjet si më poshtë:

1. Informacion mbi borxhet totale të akumuluar nga subjektet private dhe ato shtetërore për detyrimet e prapambetura për Kontributet Shoqërore.
2. Borxhet e akumuluar nga institucionet publike, apo kompanitë publike të organizuara në formën SHA, konkrete, sipas subjekteve.
3. Cilat kanë qenë masat konkrete ndaj këtyre subjekteve.
4. Sa procese gjyqësore janë aktivizuar në 5 vitet e fundit lidhur me këto problematika ndaj SHA-ve publike.

**Ju sqarojmë se:**

Në nenit 3, të Ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për Mbledhjen e Kontributeve të Detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, citohet se:

Neni 3. Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe Shëndetësore mblidhen nga organet tatimore për llogari të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjore

Në neni 10, pika 2, të po këtij ligji, citohet se: Personat juridikë dhe fizikë që janë të detyruar të paguajnë kontribute deklarojnë, në formë elektronike, në organin tatimor, të dhënat e detyrimeve për

*kontributet, sipas deklaratës përkatëse, ku përveç të tjerave, deklarohet për çdo person emri e mbiemri, numri personal, paga, shuma për t'u paguar e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore, të sigurimeve shëndetësore, si dhe e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi....*

Ndërsa në Ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar, Kreu XI, Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, neni 88 "Autoriteti dhe Kompetencat për Mbledhjen e Detyrimit Tatimor të Papaguar", pika 1, përcaktohet se:

*Administrata tatimore ka autoritetin dhe kompetencat e dhëna sipas këtij kreu për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara, për të cilat nuk është ushtruar e drejta e ankimit apo kanë kaluar të gjitha fazat e shqyrtimit administrativ dhe gjyqësor ligji i cili bën të mundur mbledhjen e detyrimeve kontributive të prapambetura nga organet tatimor.....*

Referuar sa më sipër, autoriteti ligjor të cilit duhet t'i adresohet kërkesa juaj për informacion është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, e cila është përgjegjëse për mbledhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe për mbledhjen e detyrimeve tatimor të papaguara.

Ju falenderoj për mirëkuptimin!